



## **VENDIM MBI PAPRANUESHMËRI**

**Data e miratimit: 27 qershor 2016**

**Numri i lëndës: 2015-09**

**Driton Hajdari**

**kundër**

**EULEX-it**

Paneli për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut i mbledhur me 27 qershor 2016, ku të pranishëm ishin anëtarët e paraqitur në vijim:

Znj. Magda MIERZEWSKA, kryesuese  
Z. Guénaél METTRAUX, anëtar  
Znj. Elka FILCHEVA – ERMENKOVA, anëtare zëvendësuese

Ndihmuar nga  
Z. John J. RYAN, zyrtar i lartë ligjor  
Znj. Joanna MARSZALIK, zyrtare ligjore  
Z. Paul LANDERS, zyrtar ligjor

Pas shqyrtimit të ankesës së lartpërmendur, e cila është dorëzuar në përputhje me Veprimin e Përbashkët të Këshillit 2008/124/CFSP të datës 4 shkurt 2008, Konceptin Llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 për themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut dhe rregullores së punës së Panelit siç është ndryshuar së fundi më 15 janar 2013,

Pas shqyrtimit, u vendos si në vijim:

### **I. PROCEDURAT PRANË PANELIT**

1. Ankesa është regjistruar me 30 qershor 2015. Për shkak të dorëheqjes së znj. Katja Dominik si anëtare e Panelit, pas shqyrtimit

ajo u zëvendësua nga znj. Elka Filcheva-Ermenkova, anëtare zëvendësuese e Panelit, në përputhje me rregullin 14 par. 2 të Rregullores së Punës.

## **II. FAKTET**

2. Më 17 dhjetor 2012, Gjykata e Qarkut e Prishtinës ka dënuar ankuesin dhe katër bashkë-autorët e tjerë për vrasje të rëndë në tentativë. Ankuesi ishte dënuar me shtatë vjet burgim.
3. Më 12 dhjetor 2013, pas ankesës së ankuesit, Gjykata e Apelit të Kosovës, në përbërje të një trupi gjykues të përzier të gjykatësve të EULEX-it dhe të Kosovës, ka ndryshuar aktgjykimin e shkallës së parë. Gjykata ka llogaritur kohën që ankuesi e kishte kaluar në paraburgim në kohëzgjatjen e burgimit. Pjesa tjetër e aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut ishte vërtetuar.
4. Gjykata Supreme e Kosovës, në përbërje të një trupi gjykues të përzier të gjykatësve të EULEX-it dhe gjyqtarëve vendorë ka refuzuar ankesën e mëtejshme të ankuesit si të pabazuar me 3 shtator 2014.

## **III. ANKESAT**

5. Ankuesi pohon se ishte dënuar gabimisht dhe ka pretenduar fuqishëm se ishte i pafajshëm. Ai gjithashtu ankohet për joligjshmërinë e mbajtjes së tij në paraburgim.

## **IV. LIGJI**

6. Si çështje e së drejtës materiale, Paneli është i autorizuar për të përdorur instrumentet e të drejtave të njeriut siç pasqyrohen në konceptin llogaridhënës të EULEX-it të datës 29 tetor 2009 mbi themelimin e Panelit për Shqyrtimin e të Drejtave të Njeriut. Me rëndësi të veçantë për punën e Panelit janë Konventa Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe Lirive Themelore (Konventa) dhe Konventa Ndërkombëtare mbi të Drejtat Civile dhe Politike, të cilat përcaktojnë standardet minimale për mbrojtjen e të drejtave të njeriut që duhet të garantohen nga autoritetet publike në të gjitha sistemet ligjore demokratike.
7. Para shqyrtimit të bazueshmërisë së ankesës, Paneli duhet të vendos nëse do ta pranoj ankesën, duke marrë parasysh kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me rregullën 29 të rregullores së vet të punës.
8. Sipas rregullës 25, paragrafit 1 të rregullores së vet të punës, Paneli mund të shqyrtoj ankesat që kanë të bëjnë me shkeljet e të drejtave të njeriut nga ana e EULEX-it në Kosovë gjatë ushtrimit të mandatit të tij ekzekutiv në fushën e drejtësisë, policisë dhe doganave.

9. Paneli konstaton se ankesa e ankuesit ka të bëjë me rezultatin e procedurës gjyqësore kundër tij dhe dënimin e tij gjoja të padrejtë.
10. Paneli rithekson se, ashtu siç është konstatuar në disa raste, në bazë të rregullës 25, paragrafi 1, bazuar në konceptin e llogaridhënies në OPLAN të EULEX-it në Kosovë, nuk mund të shqyrtojë procedurat gjyqësore që janë para gjykatave të Kosovës. Paneli nuk ka juridiksion rreth aspekteve administrative e as aspekteve gjyqësore të punës së gjykatave të Kosovës. Paneli tashmë ka gjetur në mënyrë të përsëritur që fakti se gjykatësit e EULEX-it ulen në trupin gjykues të çfarëdo gjykate nuk do të thotë se ia humb asaj gjykate karakterin e të qenit pjesë e sistemit juridik të Kosovës (shih, ndër të tjera, *KP kundër EULEX-it*, 2014-31, 21 prill 2015, § 13; *Shaip Selmani kundër EULEX-it*, 2014-23, 10 nëntor 2014, §12).
11. Nga kjo del se ankesa nuk hyn në kuadër të mandatit ekzekutiv të EULEX-it në Kosovë. Prandaj, kjo çështje nuk bie në kuadër të kompetencave të Panelit, siç saktësohet në rregullën 25 të rregullores së vet të punës dhe OPLAN-it të EULEX-it.
12. Në asnjë rast, parashtruesi i ankesës nuk ka ofruar pranë Panelit asnjë dëshmi të besueshme që do të mund të dëshmonte pretendimin e tij për procedura të padrejta gjyqësore.
13. Për aq sa ankesa e ankuesit mund të kuptohet që ka të bëjë me joligjshmërinë e pretenduar të paraburgimit të tij, ankesa e tij është e pabazuar pasi ankuesi nuk ka arritur të sigurojë ndonjë dëshmi në mbështetje të pretendimeve të tij.
14. Paneli tashmë ka konstatuar se ka juridiksion për të shqyrtuar veprimet dhe sjelljen e prokurorëve të EULEX-it në kuadër të hetimeve penale. Juridiksioni i tij do të mbulonte këto veprime dhe sjellje edhe kur ato do t'i ishin nënshtruar një shqyrtimi pasues gjyqësor, nëse subjekti i tyre do të kishte prekur çështjet e të drejtave të njeriut, për shembull, të drejtën e lirisë personale dhe sigurisë brenda kuptimit të nenit 5 të Konventës. Megjithatë, Paneli do të ndërhyjë vetëm nëse dhe kur akuzat për shkelje të të drejtave të njeriut që i ngarkohen prokurorit nuk janë adresuar plotësisht nga autoritetet gjyqësore kompetente (shih për shembull *Z kundër EULEX-it*, 2012-06, 10 prill 2013, § 34). Paneli konstaton se në rastin konkret ligjshmëria e paraburgimit të ankuesit ishte subjekt i vendimit të Gjykatës së Apelit. Prandaj gjykatës i ishte dhënë mundësia për të shqyrtuar plotësisht kohëzgjatjen dhe ligjshmërinë e saj. Ankuesi nuk ka identifikuar ndonjë çështje të të drejtave të njeriut që ai nuk ishte në gjendje për të ngritur në gjykatë apo se gjykata ka dështuar për ta adresuar siç duhej.

**PËR KËTO ARSYE,**

Paneli njëzëri konstaton se nuk ka kompetencë për ta shqyrtuar këtë ankesë, pasi ajo bie jashtë kompetencave të tij në bazë të nenit 29 (d) të rregullores së vet të punës dhe për shkak se ajo është e pabazuar, dhe

**SHPALL ANKESËN TË PAPRANUESHME.**

Për Panelin,

John J. RYAN  
Zyrtar i lartë ligjor



Magda MIERZEWSKA  
Kryesuese